



REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E SHKALLËS SË PARË ADMINISTRATIVE
TIRANË



Nr 1762 Akti

Nr. 1399 VENDIMI

VENDIM

NE EMER TE REPUBLIKES

Gjykata e Shkallës së Parë Administrative Tiranë e përbërë nga:

Gjyqtare: ELVANA ÇIÇOLLI

Asistuar prej sekretares **Elona Dervishi**, sot në date 18.03.2015 , mori në shqyrtim në seancë gjyqësore publike, ceshtjen administrative me nr 1762 me :

PADITES: Drejtoria Rajonale Tatimore Lezhe
përfaqësuar nga **Z.Isidor Frashni**.

I PADITUR: Drejtoria Apelitit Tatimor prane Drejtorise Pergjithshme
Tatimeve, me adrese: Rr. Gjin Bue Shpata , godina e ish
Maternitetit te Ri. (në mungesë)

PERSON I TRETET: Subjekti **Ramazan Deda** me nipt **K68015506B**

OBJEKTI: Shfuqizimin e Vendimit nr.24192/3 prot, datë 10/11/2014, të
Drejtorise Apelitit Tatimor Tiranë. Lënien në fuqi të aktit
administrate me nr.5894/3 prot date 12/08/2014, të Drejtorise
Rajonale Tatimore Lezhë

BAZA LIGJORE: Ligji nr.9920/2008 “Per Procedurat Tatimore ne RSH” dhe
Udhezimi nr.24 datë 02.9.2008 I MF në zbatim të tij. Ligjin
49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave
administrative dhe gjykimin e mosmarëveshjeve administrative në
RSH.

Gjykata pasi administroi provat e paraqitura dhe shqyrtoi kërkesë padinë

VËREN



Se pala paditëse Drejtoria Rajonale Tatimore Lezhe , I është drejtuar Gjykatës së Shkallës së Parë Administrative Tiranë, me kërkesë padi me qëllim:

“Shfuqizimin e vendimit nr: 24192/3 prot, datë 10/11/2014 te Drejtorise Apelimt Tatimor prane Drejtorise Pergjithshme te Tatimeve”

Përpara shqyrtimit të bazueshmërisë në ligj e në prova të kërkesë padisë, gjykata analizoi juridiksionin dhe kompetencën e saj në gjykimin e kësaj çështje. Në bazë të neneve 7, 8, 10, 11 të ligjit nr 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” gjykata konstatoi se çështja hyn në juridiksionin gjyqësor dhe është në kompetencën lëndore e tokësore të Gjykatës së Shkallës së Parë Administrative Tiranë.

Gjatë hetimit gjyqësor rezultoi se :

Personi i tretë Ramazan Deda është subjekt me nipt **K68015506B**. Në bazë të shkresës nr. 4455/3 prot. datë 25.05.2014, Drejtoria Rajonale Tatimore Lezhë i është drejtuar subjektit Ramazan Deda për dhënie të informacioni, mbas Letër kujtesës e nisur me nr. 2847/5 prot. datë 02.05.2014. Kërkesa e bërë nga DRT Lezhë, për dhënie informacioni nuk është plotësuar nga subjekti dhe si rezultat është gjobitur. Me Njoftim vlerësimin e sipërcituar, tatimpaguesi është njoftuar për pagesë të gjobës prej 50 000 lekësh për mosdhënie të informacionit, sipas referencës ligjore të sipërcituar dhe sipas Akt vlerësimit i mbajtur nga DRT Lezhë.

Subjekti ka pretenduar se:

Nuk jam dakort me njoftim vlerësimin nr. 5894/3 prot, datë 12.08.2014 dhe urdhër pagesën të lëshuar nga DRT Lezhë, lëshuar ne adresën time në gjobën në masën 50.000 lekë. Ju vë në dijeni se për vitin 2013, kam realizuar 450,000 lekë dhe kam takuar Inspektorët tatimor për dokumentat që duhen për bizneset me xhiro me vlerë nga 2.000.000 lekë. Inspektorët, më spjeguan verbalisht se me ligjin e ri dhe udhëzimet që kanë ardhur në Drejtorinë tonë, nuk ka pasqyra dhe deklarime për personat me xhiro nga 0-2.000.000 lekë. Prandaj nuk e shohë të arsyeshme vendosjen e gjobës, duke marrë këtë përgjigje nga Inspektorët tatimor pasi për cdo vit kam qenë shumë i rregullt me dokumentacionin.

Kundër këtij njoftimi personi i tretë është ankuar pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, Drejtoria e Apelimt Tatimor.

Drejtoria e Apelimt Tatimor, me kërkesën për plotësim dokumentacioni, nr. 24190/1 prot. Datë 14.11.2014 drejtuar DRT Lezhë, kërkoi konfirmim në lidhje me marrjen nga subjekti të shkresës nr. 4455/3 prot. datë 25.05.2014. DRT e Lezhës, e cila ktheu përgjigje në datë 01.12.2014, duke konfirmuar se kjo shkresë nuk është kthyer në DRT, por subjekti nuk është përgjigjur duke mos e paraqitur bilancin e vitit 2013.

Drejtoria e Apelimt Tatimor, duke gjykuar mbi bazën e dokumentacionit të

millionë lekë, sipas ndryshimeve të lart përmendur dhe periudha e vlerësuar është para se të miratoheshin këto ndryshime. Për periudhën që është penalizuar subjekti, ka qënë në fuqi Udhëzimi nr. 32 datë 31.12.2013., {Për tatimin e thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël”. (i ndryshuar).



➤ Arsyetim ligjor

Shqyrtimi gjyqësor i veprimtarive qeveritare e ka origjinën e vet në filozofinë e shtetit që qeveriset dhe kufizohet nga ligji dhe bazohet tek parimi i epërsisë së ligjit. Në ditët e sotme, një shtet ligjor nuk mund të mendohet pa akses për të gjithë qytetarët tek një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar në bazë të ligjit dhe e aftë për të përmbushur kërkesat e zhvillimit të një gjykimi të drejtë. Si i tillë, roli i shqyrtimit gjyqësor i veprimtarisë administrative është të mbrojë të drejtat e qytetarëve, por edhe të mbrojë interesin publik dhe rendin ligjor. Krahas këtij roli mbrojtës, kontrolli gjyqësor shihet si një mjet i rëndësishëm në rritjen e cilësisë së administrimit dhe qeverisjes së mirë.

Neni 106 i ligjit nr. 9920 date 19.05.2008, “Per Procedurat Tatimore ne Republiken e Shqiperise” parashikon se:

“1. Tatimpaguesi mund të ankimojë kundër çdo njoftim vlerësimi, çdo vendimi që ndikon në detyrimin e tij tatimor, çdo kërkesë për rimbursim ose lehtësim tatimor, ose çdo akti ekzekutiv të posaçëm tatimor, në lidhje me tatimpaguesin.”

Në këto kushte me të drejtë personi i tretë në cilësinë e tatimpaguesit i është drejtuar Drejtorise Apelitit Tatimor prane Drejtorise Pergjithshme te Tatimeve me qëllim Shfuqizimin e aktit administrativ, 5894/3 prot date 12/08/2014 të Drejtorisë Rajonale Tatimore Lezhe.

Nga ana e Drejtorise Apelitit Tatimor prane Drejtorise Pergjithshme te Tatimeve është marrë në shqyrtim ankimi dhe është shqyrtuar në bazë të Ligjit 9632, datë 30.10.2006, i ndryshuar me ligjin Nr. 85/2014,” neni 16, miratuar në datë 17.07.2014.

Nga hetimi administrativ i zhvilluar Drejtoria e Apelitit Tatimor prane Drejtorise Pergjithshme te Tatimeve ka argumentuar se:

“ Për periudhën që DRT Lezhë i ka kërkuar informacion subjektit në lidhje me dorëzimin e bilancit, për vitin 2013, nuk ishin miratuar ndryshimet e ligjit 9632 datë 30.10.2006, hyrë në fuqi 15 ditë pas botimit në fletoren zyrtare,(miratuar në datë 17.07.2014).

- Në këto kushte, tatimpaguesi nuk ka detyrim ligjor për paraqitjen e bilancit për vitin 2013, pasi nuk kaluar qarkullimin vjetor mbi 2 (dy) milionë lekë, sipas ndryshimeve të lart përmendur dhe periudha e vlerësuar është para se të miratoheshin këto ndryshime.

Për periudhën që është penalizuar subjekti, ka qënë në fuqi Udhëzimi nr. 32 datë 31.12.2013., {Për tatimin e thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël”, (i ndryshuar),

Sikurse shihet në këtë udhëzim nuk kanë detyrime për paraqitjen e deklaratave tatimpaguesit me xhiro vjetore nga 0 (zero) deri në 2 (dy) milionë lekë

Në këto kushte me të drejte ka shfuqizuar Njoftim Vlerësimi për Detyrimet Nr. 5894/3 prot, datë 12.08.2014, të Drejtorisë Rajonale Tatimore Lezhë.

Kjo pasi sipas Ligjit 9632, datë 30.10.2006, i ndryshuar me ligjin Nr. 85/2014, neni 16, miratuar në datë 17.07.2014, parashikohet:

“ Çdo tatimpagues, subjekt i tatimit të thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël, me qarkullim nga 2 (dy) deri në 8 (tetë) milionë lekë, është i detyruar që deri më 10 shkurt të vitit që pason periudhën tatimore të dorëzojë një deklaratë vjetore tatimore, ku të jepen hollësisht të ardhurat gjithsej, shpenzimet e zbritshme, fitimi i tatueshëm, tatimi për t'u paguar, si dhe çdo hollësi tjetër e përcaktuar me udhëzim të Ministrit të Financave për plotësimin dhe dorëzimin e deklaratës tatimore vjetore. Detyrimin për paraqitjen e deklaratës vjetore në afatin e mësipërm e kanë edhe të gjithë tatimpaguesit e tatimit të thjeshtuar mbi fitimin me qarkullim vjetor nga 0 (zero) deri në 2 (dy) milionë lekë....”

Sipas Udhëzimit nr. 32 datë 31.12.2013., {Për tatimin e thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël”, (i ndryshuar), thuhet:

9.1. Çdo tatimpagues, subjekt i tatimit të thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël, me qarkullim nga 2 deri në 8 milionë lekë, është i detyruar që, deri më 10 shkurt të vitit që pason periudhën tatimore, të dorëzojë një deklaratë vjetore tatimore, ku të jepen hollësisht të ardhurat, gjithsej, shpenzimet e zbritshme, e ardhura e tatueshme, tatimi për t'u paguar, si dhe çdo informacion tjetër i kërkuar me akte të tjera ligjore apo nënligjore. Tatimi i llogaritur në bazë të deklaratës vjetore të të ardhurave të tatueshme, pakësuar me parapagimet e bëra gjatë periudhës tatimore, paguhet nga tatimpaguesi në llogarinë e organeve tatimore, në çastin e paraqitjes së deklaratës vjetore.

Drejtoria e Apelit Tatimor me të drejtë ka argumentuar se personi i tretë nuk ka patur detyrim për të deklaruar për shkak të xhiros vjetore nën 2 milion lekë.

Sipas nenit 9 të Kodit të Procedurave Administrative :

“Organet e administratës publike e zhvillojnë veprimtarinë e tyre në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, Marrëveshjet Ndërkombëtare në të cilat Republika e Shqipërisë aderon, ligjet e Republikës së Shqipërisë, brenda kufijve të kompetencave që iu janë dhënë atyre dhe konform qëllimit për të cilin janë dhënë këto kompetenca.;..”

Legjislatori i ka kushtuar parimit të ligjshmërisë një rëndësi të natyrshme që justifikohet nga rëndësia e marrëdhënieve të administratës me individët. Ky parim kërkon jo vetëm që autoritetet administrative të mos shkelin ligjin por edhe që të gjitha aktet e nxjerra prej tyre të jenë të autorizuara qartë nga ligji dhe përmbajtja e këtyre akteve të jetë në përputhje me atë ligj. Për më tepër, ky parim presupozon që përmbajtja e organeve administrative ndaj këtyre kërkesave të jetë e zbatueshme në praktikë.

Neni 121 i K.Pr.A parashikon mundësinë e shfuqizimit të akteve administrative relativisht të pavlefshme:

“Aktet administrative shfuqizohen ose revokohen me nismën e organit kompetent ose si rezultat i kërkesës për shqyrtim apo apelimit të palëve të interesuara.

Aktet administrative absolutisht të pavlefshme nuk mund të shfuqizohen apo revokohen.”

Doktrina ka sqaruar se:

Shfuqizimi është e drejta e organit epror administrativ që me anë të një akti të ri të shfuqizojë aktin e kundërshtuar. Për t'u realizuar shfuqizimi i aktit duhet të ketë detyrimisht një ankim administrativ nga pala e interesuar me qëllim që të vihet në lëvizje organi kompetent për të zhvilluar procedurën përkatëse. Nisma e organit epror në këto raste nuk mund të realizohet, pasi duhet detyrimisht që të ketë një ankim nga dikush që të shfuqizohet akti i kundraligjshëm. Megjithatë nuk përjashtohen rastet kur organi epror që shfuqizon një akt të organit më të ulët, të shfuqizojë përveç këtij akti edhe aktet e tjera që mund të jenë marrë si rrjedhoje e aktit të shfuqizuar.

Shfuqizimi dhe revokimi aplikohet vetëm për aktet relativisht të pavlefshme të cilat janë akte që prodhojnë efekte juridike deri në momentin që atyre u pushon fuqia juridike. Është e qartë se aktet absolutisht të pavlefshme nuk mund të shfuqizohen apo revokohen, përse kohë ato, sipas kuptimit që i jep ky Kod dhe teoria në përgjithësi, nuk mund të konsiderohen akte. Një akt që është nul që në momentin që është nxjerrë dhe që konsiderohet sikur nuk ka ekzistuar për asnjë çast, nuk mund të shfuqizohet dhe as të revokohet. Shfuqizimi dhe revokimi u bëhet akteve që kanë ekzistuar deri në momentin që u pushon kjo fuqi juridike. Organi kur ndeshet me akte të tilla ka për detyrë të rregullojë pasojat që akti absolutisht i pavlefshëm ka krijuar por në asnjë mënyrë të shprehet për shfuqizimin e një akti që nuk ka dhe as nuk mund të ketë patur ndonjëherë fuqi juridike.

Aktet administrative i pushojnë efektet e tyre ligjore, nëpërmjet deklarimit të një vullneti juridik nga organet përkatëse, të cilat e kanë një kompetencë të tillë. Ky deklarim vullneti kryhet me anë të nxjerrjes së aktit të ri juridik, i cili mund të revokojë, shfuqizojë, apo ndryshojë aktin e mëparshëm, të cilit nuk duhet t'i vazhdojnë më tej efektet e tij juridike.

Kur organi administrativ kompetent shqyrton vlefshmërinë e aktit që ka nxjerrë vetë ose të një organi më të ulët, duhet të ndjekë të njëjtën procedurë që ligji parashikon për nxjerrjen e aktit. Nxjerrja e aktit kërkon respektimin e të gjitha kërkesave ligjore, pasi përndryshe moszbatimi i këtyre kërkesave mund të sjellë pavlefshmërinë e aktit. Pra respektimi i formës së aktit, qëllimi i tij dhe veçanërisht arsyetimi janë elementë të domosdoshëm që duhet të respektohen edhe gjatë nxjerrjes së aktit revokues apo shfuqizues. Gjithashtu edhe procedura që fillon që me njoftimin e palëve të interesuara në aktin që po shqyrtohet, dëgjimi i pretendimeve që mund të kenë ndaj aktit të ankimuar etj, janë të domosdoshme për tu respektuar.

Marrja e një forme të caktuar të aktit revokues apo shfuqizues si dhe ndjekja e një procedure të caktuar krijojnë mundësitë e një shqyrtimi dhe zgjidhjeje të drejtë të çështjes si dhe njëkohësisht i japin të gjitha mundësitë palëve të interesuara që nuk janë dakort me



zgjidhjen për ta dërguar çështjen në një organ tjetër administrativ ose përfundimisht në gjykatë. Pikërisht zbatimi i këtyre rregullave formale dhe proceduriale i shërbejnë edhe transparencës që është një nga parimet bazë që duhet të udhëheqë administratën tonë. Ky është rregulli i përgjithshëm që duhet të karakterizojë çdo organ administrativ që revokon apo shfuqizon një akt

Njoftim vlerësimi i Drejtorisë Rajonale Tatimore Lezhë është një akt administrativ i cili pasqyron vullnetin shtetëror të këtij organi. Në këtë këndvështrim ai duhet të jetë në përputhje me legjislacionin në fuqi. Një vendim administrative i marrë në kundërshtim me ligjin duhet të konsiderohet si relativisht i pavlefshëm e për pasojë duhet të shfuqizohet.

Vendimi i Drejtorisë së Apelit Tatimor pranë Drejtorisë Përgjithshme Tatimeve për shfuqizimin e Njoftim Vlerësimi për Detyrimet Nr. 5894/3 prot, datë 12.08.2014, të Drejtorisë Rajonale Tatimore Lezhë është një vendim i drejtë dhe bazuar në ligj.

Për shkak të parashikimeve të nenit 45/b të ligjit nr 49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatave Administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative ky vendim është i paankimueshëm.

PËR KËTO ARSYE


Gjykata bazuar në nenet 126, të Kodit të Procedurës Civile, nenit 40 të ligjit nr 49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatave Administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative"

VENDOSI

1. Rrëzimin e kërkesë padisë me nr 1762 Akti me palë paditëse Drejtoria Rajonale Tatimore Lezhë.
 2. Shpenzimet gjyqësore si janë kryer.
 3. Ky vendim është i formës së prerë.
- U shpall sot në Tiranë më datë !

SEKRETARE

ELONA DERVISHI



GJYQTARE

ELVANA ÇIÇOLLI

